



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1140/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI149/16

Parashtrues

Komuna e Klinës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, CML. nr. 13/2016, të 13 shtatorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Ali Shala, përfaqësues ligjor-Avokat Shtetëror i Komunës së Klinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 13/2016, të 13 shtatorit 2016. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 31 tetor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet shkeljes së ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 dhjetor 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 27 shkurt 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh të plotësojë kërkesën.
8. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
9. Më 3 mars 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentet e kërkuara.
10. Më 6 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 12 maj 2010, parashtruesi i kërkesës dhe N. P. "Morina Automobile" (në tekstin e mëtejme: kreditori), nënshkruajnë kontratë për shërbime të transportit me merimangë.
12. Më 29 shtator 2011 dhe 25 maj 2012, palët i nënshkruajnë edhe dy kontrata tjera me qëllim të zgjatjes së bashkëpunimit mes tyre.

13. Ndërkohë u shfaqën mosmarrëveshje ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe kreditorit për përmbushje të detyrimeve financiare, ndaj këtij të fundit, për shërbimet e ofruara.
14. Më 10 mars 2015, kreditori i dorëzoi Zyrës së Përmbaruesit Privat propozimin për përmbarim, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve financiare nga parashtruesi i kërkesës. Propozimi ishte paraqitur në bazë të “dokumentit të besueshëm”, faturës nr. 267, të 25 shkurtit 2015.
15. Më 11 mars 2015, Zyra e Përmbaruesit Privat lejoi propozimin e kreditorit për përmbarimin e faturës nr. 267, të 25 shkurtit 2015.
16. Më 23 mars 2015, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Pejë ushtroi prapësim kundër Urdhrit për Përmbarim të Zyrës së Përmbaruesit Privat.
17. Më 6 gusht 2015, Gjykata Themelore në Pejë me Aktvendimin C. P. nr. 7/15, pjesërisht aprovoi prapësimin e parashtruesit të kërkesës, kurse pjesërisht e vërtetoi Urdhrin Përmbarues të Zyrës së Përmbaruesit Privat.
18. Më 23 shtator 2015, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore.
19. Më 28 janar 2016, Gjykata Apelit me Aktvendimin AC. nr. 3906/20, refuzoi ankesën e parashtruesit të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.
20. Më 2 mars 2016, Zyra e Përmbaruesit Privat urdhëroi Ministrinë e Financave (Departamenti i Thesarit) që të ekzekutojë pagesat në përputhje me vendimet gjyqësore.
21. Më 14 mars 2016, parashtruesi paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktvendimeve të lartpërmendura të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që kërkesa e kreditorit për përmbarim të shpallet e paafatshme; ose që, vendimet e gjykatave të instancës më të ulët të anulohen dhe çështja të kthehet për rigjykim.
22. Më 25 mars 2016, Ministria e Financave nxori urdhrin e pagesës për përmbarim të vendimeve gjyqësore.
23. Më 25 prill 2016, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit që të ngre kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.
24. Më 12 maj 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njoftoi parashtruesin se ka miratuar iniciativën e tij dhe ka paraqitur në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të lartpërmendura të gjykatave të instancës më të ulët. Prokurori i Shtetit paraqiti kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që

vendimet e kundërshtuara të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

25. Më 13 shtator 2016, Gjykata Supreme me Aktvendimin Cml. nr. 13/2016, refuzoi të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, të paraqitur kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi thekson se *“Konsiderojmë se në rastin konkret kemi të bëjmë me paraqitjen e kërkesës tonë mbi bazë të dispozitës së nenit 113, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ngase vlerësojmë se: Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast konkret komuna përkatëse është prekur nga ai ligj apo akt”*.
27. Parashtruesi, më tej, pretendon se *“Në rastin konkret Komuna e Klinës si debitor në këtë rast e ka pranuar më dt.31.10.2016 Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Cml. nr. 13/2016 të dt.13.09.2016 me të cilin rasti përfundimisht ishte vendosur në disfavorin tonë atëherë kemi konsideruar se jemi prekur nga vendimi i tillë gjyqësor i jashtëligjshëm po edhe nga veprimi dhe akti i Ministrisë së Financave-Departamenti i Thesarit në Prishtinë i cili më dt. 25.03.2016 drejtpërsëdrejti kishte bartur mjetet financiare nga Llogarija e Komunës së Klinës në Llogaria të N. T. "Morina Automobile" në Klinë, kinse sipas Urdhrit për lejimin e përmbarimit më shenjën P.nr.219/15 i dt. 02.03.2016 të Përmbaruesit privat Gj. R. me seli në Gjakovë dhe këtë sipas evidencës tonë që e kemi nga Raporti Free balancit i dt.25.03.2016 në vlerën prej 88,798.76€.”*
28. Në fund, parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës që të shpallë kërkesën të pranueshme dhe t'i anulojë të gjitha vendimet gjyqësore dhe Urdhrit e Ministrisë së Financave.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 paragrafëve 1, 4 dhe 7, [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.,

[...]

4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Gjykata po ashtu i referohet nenit 21, paragrafi 4, të [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara me Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridik, për aq sa janë të zbatueshme”.

32. Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

Neni 48

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

33. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (2) (a) dhe (c) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet *prima facie*, ose

[...]

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë;”

34. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës; dhe se, kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
35. Gjykata më tej duhet të vërtetojë nëse parashtruesi i kërkesës ka saktësuar dhe mbështetur pretendimet e tija kushtetuese siç parashihet me nenin 48 të Ligjit.
36. Gjykata, gjithashtu, ka parasysh pozitën juridike të Komunës si person juridik, në bazë të nenit 5 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.
37. Në këtë drejtim, Gjykata si çështje paraprake vëren se, pavarësisht nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës, kërkesa nën shqyrtim do të vlerësohet në kuadër të neneve 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, sepse vendimet e kontestuara

janë vendime gjyqësore kurse akti përmbarues i Ministrisë së Financave është nxjerrë si rrjedhojë dhe në funksion të zbatimit të vendimeve gjyqësore (shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI48/14 dhe KI49/14, Parashtrues i kërkesës, *Komuna e Vushtrrisë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 majit 2016, paragrafi 49).*

38. Gjykata vëren se thelbi i kërkesës është pretendimi i parashtruesit të kërkesës se vendimet gjyqësore dhe urdhri i pagesës i Ministrisë së Financave janë nxjerrë pa asnjë bazë ligjore apo kushtetuese.
39. Në këtë drejtim, Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk i referohet shkeljes së ndonjë prej dispozitave kushtetuese që ofrojnë garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për aq sa ato janë të zbatueshme edhe për personat juridiko-publik.
40. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për *“vendime gjyqësore të nxjerra pa asnjë bazë gjyqësore”*, arsyetimi i Gjykatës Supreme mund të përmbledhet si vijon: *“Gjykata e Apelit e Kosovës, në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat materiale, kur e lë gjykata e shkallës së parë, pjesërisht në fuqi urdhrin për përmbarim të përmbaruesit privat. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, kreditori ka kryer shërbimet për debitorin, sipas kontratave të lidhura në periudhën prej 12.05.2010 gjer më 24.05.2015, duke kryer shërbimet e transportit dhe parkimit të automjeteve të konfiskuara nga Policia e Kosovës...duke u nisur nga gjendja e tillë e “çështjes Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e instancës më të ulët në mbështetje të gjendjes të vërtetuar faktike drejt ka zbatuar dispozitat materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e kreditorit pjesërisht është e bazuar.”*
41. Nga përmbajtja e kërkesës, rezulton se gjykatat i kanë vlerësuar të gjitha çështjet qendrore siç janë: (i) vlerësimi i kontratave dhe raportit juridiko-detyrimor ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe kreditorit; (ii) vlerësim të “dokumentit të besueshëm” për lejim të përmbarimit; (iii) vlerësimin e borxhit të saktë që parashtruesi i kërkesës i detyrohej kreditorit për shërbimet e kryera; dhe, (iv) vlerësim të vjetërsimit të një pjese të borxhit që parashtruesi i kërkesës i detyrohej kreditorit.
42. Kushtetuta nuk garanton rezultat të favorshëm në rastin e dikujt, dhe as nuk lejon që Gjykata ta vë në pyetje drejtësinë materiale të rezultatit të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI142/15, parashtrues i kërkesës, *Habib Makiqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 231/2015, të 1 shtatorit 2015, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).*
43. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideroi relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të

kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtarë; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimit të goditur ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (Shih, për shembull, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

44. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për atë që mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
45. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
46. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
47. Në fund, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i referohet ndonjë prej dispozitave kushtetuese dhe në përgjithësi përshkruan dhe ngre çështje ligjore, pa dëshmuar saktësisht dhe pa ngritur pretendimet e tija në nivel kushtetues siç parashihet me nenin 48 të Ligjit.
48. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Faktet e rastit nuk tregojnë se Gjykata ka vepruar në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me Kushtetutë.
49. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta arsyetojë kërkesën e tij *prima facie* dhe rrjedhimisht, nuk mund të pretendojë se është subjekt i shkeljes të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë.
50. Në bazë të vlerësimeve të mësipërme, kërkesa, në baza kushtetuese, është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 36 (2) (a) dhe (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (a) dhe (c) të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

